



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:174904

Datë: 23.11.2022

Numri i dokumentit: 03695640

2021:185968

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.Th. nga Ferizaj, për shkak të veprave penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së dhe Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1115/2021, të datës 20.08.2021, ka mbajtur shqyrtimet gjyqësore publike më datat 14.10.2022, 21.11.2022 dhe 23.11.2022, në praninë e prokurorit të shtetit Ardian Emini, të dëmtuarit I.Th. dhe të akuzuarit dhe në shqyrtimin e fundit gjyqësor, morri dhe komunikoi dhe të njëjtën ditë edhe përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B.Th., nga i ati I..., e ëma M..., e gjinisë K..., i lindur me dt. në fshatin K. Lipjan, me vendbanim në Ferizaj rruga “...” nr.... me numër personal, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i martuar baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovë, i pa dënuar më parë për ndonjë vepër penale, ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale.

Konform nenit 363 par. 1 pika 1.1 të KPPK-së.

REFUZOHET AKTAKUZA

1. Sepse me datë 27.05.2021 në Rr.”...” në Ferizaj, pas mosmarrëveshjeve pronësore me të dëmtuarin vëllain e tij I.Th. lidhur me ndarjen e pasurisë-shtëpisë, mbi të cilën ishte vendosur masa e përkohshme e sigurimit, sipas aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.659/19, me të cilën tani të pandehurit i ishte ndaluar që ta tjetërsojë, fshehtë apo ta ngarkoj paluajtshmerinë me nr..... në sipërfaqe prej 1412 metra katrorë Zona Kadastrale Ferizaj në vendin e quajtur “...”- i pandehuri, hyn në shtëpinë e të dëmtuarit dhe me atë rast i demolon orenditë në dhomat e gjumit, një depo të ushqimit dhe muret në shtëpi duke tentuar ta djegë edhe një dyshek të shtratit.

Me këtë kishte për të kryer veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par 1 të KPRK-së.

2. Nga periudha kohore mes datës 27.05.2021 deri me datë 19.08.2021, në Rr.”...”, në Ferizaj i pandehuri nuk i është bindur vendimit gjyqësor, përkatësisht aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.659/19 të datës 03.01.2020 me të cilën tani të pandehurit i ishte ndaluar që ta tjetërsojë, fshehtë apo ta ngarkoj paluajtshmerinë me nr..... në sipërfaqe prej 1412 metra katror Zona Kadastrale Ferizaj në vendin e quajtur “.....”.

Me këtë kishte për të kryer veprën penale Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par 1 të KPRK-së.

Për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza në fund të shqyrtimit gjyqësor, respektivisht në fjalën përfundimtare.

Pala e dëmtuar I.I.Th. nga Ferizaj, rr.”...”, ndërtesa ..., hyrja ..., kati .., nr....., për realizimin e kërkesave pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.1115/2021, të datës 20.08.2021, kundër të akuzuarit për shkak të veprave penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së dhe Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjyqtari i vetëm gjykues, duke vepruar sipas kësaj çështje penale me datat 14.10.2022, 21.11.2022 dhe 23.11.2022, ka mbajtur shqyrtimet gjyqësore, në të dy seancat e para në prani të prokurorit të shtetit Ardian Emimi, ndërsa seancën e fundit në prani të prokurorit të shtetit Besnik Nuredini, të dëmtuarit dhe të akuzuarit.

Në shqyrtimin e fundit gjyqësor të datës 23.11.2022, prokurori i shtetit Besnik Nuredini deklaroi në pamundësi të prezencës në këtë seancë gjyqësore të prokurori i shtetit Ardian Emimi, i cili ka marrë pjesë në seancat e mëparshme gjyqësore, gjykatës dhe palëve u dorëzoi fjalën përfundimtare të tij të përgatitur me shkrim dhe të njëjtën unë nuk do të elaboroj, por qëndroj pranë fjalës përfundimtare të përgatitur nga prokurori i çështjes. Gjyqtari pas leximit të fjalës përfundimtare të dorëzuar me shkrim, konstatoi se prokurori i çështjes në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim është tërhequr nga aktakuza për të akuzuarin dhe atë për të dy veprat penale, për shkak të veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së dhe veprës penale Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 të KPRK-së,

Pasi që prokurori i shtetit është tërhequr nga ndjeka penale ndaj të akuzuarit, gjyqtari i vetëm gjykues, në mbështetje të nenit 363 par.1 nën par.1.1 të KPP-së, vendosi si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 454 par. 1 të KPPK-së, shpenzimit e paushallit gjyqësor bien ne barre te buxhetit te shtetit.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
2021:185968, më datë 23.11.2022

Zyrtare ligjore
Kimete Bytyqi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Imri Sejda

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e parë e ardhshme pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj, për Gjykatën e Apelit të Kosovës.